

Specifikime Teknike per Pjeset e Kembimit

- Tabelat e artikujve/mallrave te kerkuar te paraqitura me siper duhet te plotesohen rigorozisht nga ofertuesi per te gjithë zerat e pjeseve te kembimit qe kerkohen ne keto tabela.
- Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese autorizimin e prodhuesit/ve ose distributoreve me te cilet bashkepunon per te gjithë artikujt/mallrat objekt i ketij prokurimi. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit/ve distributoreve si: telefon,fax, e-mail,website kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.
- Pjesa e garancisë së pjeseve te kembimit të jetë e plotësuar dhe të shoqërojë mallin në momentin e dorëzimit të tij.
- Shoqeria kontraktuese mban pergjegjesi per çdo difekt ose mosperputhje te pjeseve edhe kur defekti ose mosperputhja shfaqet gjate procesit te riparimit.
- Shoqeria kontraktuese, pas marrjes së njoftimit për çdo defekt ose mosperputhje duhet te zevendesoje mallin ose Garancia e pjeseve te kembimit te jete jo me pak se 3 (tre) muaj nga momenti i venies ne pune te tyre.
- Te gjitha pjeset e kembimit te jene te ambalazuara ne kuti kartoni apo veshje plastike si dhe te kene percaktim te mire ne etikete per llojin dhe marken e tyre.

Specifikime Teknike per Gomat

1. Gomat të jenë të reja (të pa riveshura).
 2. Në sipërfaqet anësore, çdo gomë duhet të ketë të stampuara këto të dhëna:
- Prodhesi (marka)
 - Emërtimi i gomës
 - Përmasat e gomës (sipas kërkesave) dhe profili i batistradës
 - Indeksi i ngarkesës dhe i shpejtësisë
 - Struktura e gomës (radiale ose diagonale)
 - Tipi i gomës (Tubeless / Tube Type).
 - Numri i miratuar UN/ECE i prodhuesit të gomës (tregon se prodhimi i gomave bëhet në përputhje me rregullat e vendosura nga UN/ECE)
 - E (standarti i BE) ose DOT (standarti amerikan).
 - Kodi i prodhuesit të gomës.

- Kodi i gomës (për shembull EA – Kodi i gomës 295/80 R 22 H).
 - Data e prodhimit.
3. Të jenë të prodhimit për përdorim për 4 stinë (All Season), me simbolet dhe shenjat përkatëse.
 4. Të jenë të prodhimit jo më herët se 12 muaj nga data e zhvillimit të tenderit.
 5. Gomat e një dimensionit të jenë të gjitha të të njëjtit marke/tip prodhimi .

Garancia

- Çertifikata e garancisë së gomave të jetë e plotësuar dhe të shoqërojë mallin në momentin e dorëzimit të tij.
- Garancia jo më pak se 45.000 (dyzetë e pese mijë) kilometra. Shoqëritë gjatë periudhës së garancisë janë të detyruara të kryejnë zëvendësimin e gomave me difekt për shkak të prodhimit ose cilësisë së dobët, pas marrjes së njoftimit nga enti pritës i mallit

Specifikime Teknike per Baterite

1. Koha e prodhimit të baterive të jetë jo më shumë se 6 muaj nga data e lëvrimit të mallit;
2. Bateritë duhet të jenë të plotësuara me solucion në rastin kur ato janë hermetike;
3. Bateritë e thata (Në rastin kur kërkohen të tilla nga Autoriteti Kontraktor, te cilat kërkojnë mbushje me solucion) duhet të shoqërohen me sasinë e duhur të solucionit mbushës dhe ujit të distiluar (për plotësim niveli gjatë procesit të punës).
4. Në raste specifike, kur nevojiten bateri me pozicion të poleve (+ ose -) në vendndodhje të kundërta në bateri, shitësi të marrë përsipër zëvendësimin reciprok të tyre.

Garancia per te gjitha llojet e baterive:

1. Bateritë të garantojnë punë të rregullt deri në 12 muaj nga dita e furnizimit.
2. Çertifikata e garancisë së baterive të jetë e plotësuar dhe të shoqërojë mallin në momentin e dorëzimit të tij.